**Ndjekja dhe regjistrimi** janë matës të pjesëmarrjes në sistemin arsimor. Sidoqoftë, është e mundur që një person të regjistrohet dhe jo të ndjekë një nivel arsimor, dhe e kundërta. Në këtë kuptim ato masin gjëra të ndryshme, dhe janë të dy të rëndësishëm për të kuptuar situatën. Regjistrimi në shkolla matet nga burim administrativ dhe mbahet për të gjithë sistemin arsimor në vend.

**Normat neto dhe bruto** të regjistrimit/ndjekjes janë matës të standartizuar të pjesëmarrjes në arsim.

**Normat neto** llogariten duke pjestuar numrin e fëmijëve në moshën e arsimit zyrtar (psh 6-10 vjeç për shkollën fillore) të cilët janë duke e ndjekur këtë nivel, me numrin total të fëmijëve në atë grupmoshë. Ky matës nuk mat nëse fëmija është në shkollë, por nëse është në nivelin arsimor të përshtatshëm për moshën e tij.

**Normat bruto** llogariten me të njëjtin koncept, por përfshin të gjithë popullatën në një nivel të caktuar, pavarësisht moshës, duke e pjestuar me numrin e fëmijëve në moshën për atë nivel arsimor. Normat bruto zakonisht janë më të larta se ato neto, kur në një nivel të caktuar shkolle ka fëmijë nën moshën e përcaktuar ose mbi moshën e përcaktuar.

**Indeksi i barazisë gjinore** krahason burrat dhe grat bazuar në normën bruto të regjistrimit (psh, numri i fëmijëve i cdo moshe që janë regjistruar në arsimin primar mbi numrin total 6-10 vjeç). Një indeks i barabartë me 1 tregon barazi gjinore, Më pak se 1.0 tregon pabarazi në favor të burrave dhe më i madhe se 1.0 pabarazi në favor të grave.

**Koeficienti i divorcit:** Është numri i divorceve për 100 martesa në një vit të dhënë.

## 5. Education

**Enrolment and attainment** are measures of participation in the education system. However, it is possible for a person to enroll and not to attend an educational level, and vice versa. In this sense they measure different things, and they are both important to understanding the situation. School enrollment is measured from an administrative source and maintained for the entire education system in the country.

**Net and gross** enrolment/attendance rates are standardized rates to measure participation in education.

**Net rates** are calculated by dividing the number of children in the age of formal education (e.g. 6-10 years old for primary school) who are following this level, with the total number of children in that age group. This indicator does not measure whether the child is in school, but whether it is at the appropriate educational level for his age.

**Gross rates** are accounted for by the same concept, but include the whole population at a certain level, regardless of age, by dividing the number of children in the age for that level of education. Gross rates are usually higher than net ones when at a certain school level there are children under defined age or over defined age.

**The gender parity index** compares boys and girls based on the gross enrollment rate (e.g., the number of children of any age enrolled in primary education over the total number of 6-10 years). An index equal to 1 shows gender equality, Less than 1.0 shows inequality in favor of men and greater than 1.0 inequality in favor of females.

## 6. Krimet

**I paraburgosur:** Është çdo person, shtetas shqiptar, i huaj apo pa shtetësi, ndaj të cilit është marrë masë sigurimi “arrest në burg.

**I dënuar:** Është çdo person, shtetas shqiptar, i huaj apo pa shtetësi, i dënuar me burgim me vendim të formës së prerë të gjykatave shqiptare dhe në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare edhe të gjykatave të huaja, duke respektuar kërkesat përkatëse procedurale. Krime seksuale realizohet nëpërmjet përdorimit të dhunës duke kryer marrëdhënie seksuale me force pa dëshirën e viktimës.

Këtu hyjnë dhe marrëdhëniet me të mitur. Zakonisht ky lloj krimi në pjesën më të madhe të rasteve nuk denoncohet nga viktimat për arsye të ndjenjës së turpit dhe frikës.

**I pandehur** cilësohet personi të cilit i atribuohet vepra penale me aktin e njoftimit të akuzës, në të cilin tregohen të dhënat e mjaftueshme për marrjen si të pandehur.

**Numri i të burgosurve** tregon gjendjen e të burgosurve në një vit të caktuar duke përfshirë hyrjet e reja dhe daljet që ndodhin për periudhën, dhe llogaritet si një mesatare e numrit të burgosurve për çdo muaj.

**Dhuna psikologjike:** Përfshin një sërë sjelljesh që kanë për qëllim të kontrollojnë ose izolojnë, të trembin dhe shkaktojnë frikë, të sulmojë karakterin e një gruaje dhe të ulin vetvlerësimin e saj.

**Dhuna fizike:** Është përdorimi i forcës fizike kundrejt një personi në një mënyrë që ta dëmtojë ose ta vërë në rrezik atë.

**Dhuna seksuale:** Është çdo situatë në të cilën një grua detyrohet të marrë pjesë në aktivitete seksuale të padëshirurara, të pasigurta, degraduese dhe/ose poshtëruese.

## 6. Crime

**The detainees:** Is any person, Albanian, foreign or stateless, to whom the security measure “detention in prison” is taken.

**Convicted:** Is any person, Albanian, foreign or stateless sentenced to imprisonment by a final decision of Albanian courts in accordance with international agreements and foreign courts, respecting the requirements during the process. Sexual crime is achieved through violence used, by having forced sexual intercourse without the victim's consent.

Juvenile sexual intercourse is included here as well. In most of the cases the victims do not denounce this type of crimes because of the complex of fault and intimidation.

**A defendant** is considered the person to whom the criminal offence has been attributed through the act of notification of accusation, which contains sufficient evidence for taking the person as a defendant.

**The number of prisoners** shows the situation of prisoners' in a given year including new admissions and releases that occur during the period concerned, and is calculated as an average of the number of prisoners per month.

**Psychological violence:** Includes a range of behaviors that aim to control and isolate, intimidate and cause fear, and attack a woman's character and undermine her sense of self-worth and self-esteem.

**Physical violence:** Is the use of physical force against someone in a way that injures or endangers that person.

**Sexual violence:** Is any situation in which a woman is forced to participate in or perform unwanted, unsafe, degrading, and/or humiliating sexual activities.

## 7. Punësimi:

Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës: Llogaritet si rraport i popullsisë ekonomiksht aktive me popullsinë në moshë pune gjatë periudhes referuese. Forca e punës përfshijnë të gjithë personat në moshë pune, që gjatë një periudhë reference punojnë, si dhe të gjithë të papunët e regjistruar.

**Shkalla e punësimit:** Llogaritet si raport i popullsisë ekonomiksht aktive me popullsinë në moshë pune gjatë periudhes referuese.

**Shkalla e papunësisë:** Llogaritet në përqindje si raport i të papunëve gjithsej të regjistruar gjatë periudhes referuese me forcat e punës gjithsej.

**Shërbimeve të tregut** përfshin aktivitetet e tregtisë me shumicë dhe pakicë; riparimi i automobilave; hotelet dhe restorantet; transportet, magazinimi dhe komunikacioni; ndërmjetësimi monetar dhe financiar; pasuritë e patundshme).

**Shërbime jo të tregut** përfshijnë aktivitetet e Administrimit publik, Shërbimet Sociale dhe aktivitetet e shërbime të tjera.

**Indeksi i Pabarazisë Gjinore:** IPB tregon humbjen potenciale në zhvillimin njerëzor, si rezultat i pabarazive ndërmjet arritjeve të burrave dhe grave. Ky indeks përlogaritet në dimensionin shëndeti riprodhues, fuqizimi politik dhe arsimor, tregu i punës.

## 7. Employment:

The participation rate in the labor force: Calculated as the ratio of the economically active population in the working age population during the period. The labor force includes all persons of working age, during a reference period of work, and all registered unemployed.

**Employment rate:** Calculated as the ratio of the economically active population in the working age population during the reference periods.

**Unemployment rate:** Percentage calculated as the ratio of total registered unemployed during the reference period by the total labor force.

**Market services** sector include activities of wholesale and retail trades, repair of automobile, hotels and restaurants, transport, storage and communication, monetary and financial intermediation, real estate.

**Non Market Services** include activities Public Administration, Community, Social and other Services and Activities

**Gender inequality index:** GII show the loss in potential human development due to inequality between females and males. This index is based on three dimensions: reproductive health, empowerment and labor market.



## Hendeku Gjinator i Pagave

### Hyrje

Çfarë është hendeku gjinator i pagave? Hendeku Gjinator i Pagave është një tregues i mirë për të paraqitur diferencat në të ardhura ndërmjet grave dhe burrave. Këto diferenca janë rrjedhojë e faktorëve të ndryshëm duke filluar që nga zgjedhjet e ndryshme në tregun e punës deri tek diskriminimi gjinator. Ky tregues llogaritet si diferenca në pagë mesatare ndërmjet grave dhe burrave. Zakonisht kjo diferencë raportohet si përqindje e pagës së burrave, pra:

$$HGjP = \frac{Paga\ mesatare\ e\ meshkujve - Paga\ mesatare\ e\ femrave}{Paga\ mesatare\ e\ meshkujve}$$

## Gender Pay Gap

### Introduction

What is gender pay gap?

Gender Pay gap is a good indicator in order to present differences in income between women and men. These differences are a consequence of different factors starting from different choices in the labor market to the gender discrimination. This indicator is calculated as the difference in the mean wage between women and men. Usually this difference is reported as a percentage of the wage of men.

$$GPG = \frac{Mean\ wage\ of\ men - Mean\ wage\ of\ women}{Mean\ wage\ of\ men}$$

Eurostat e llogarit hendekun gjinator të pagave duke përdorur të dhënat e Anketës së Strukturës të të Ardhurave nga Puna. Kjo anketë pranë bizneseve nuk është zhvilluar ndonjëherë nga INSTAT, por do të zhvillohet së shpejti. Burimi më i mirë që disponon Instat për llogaritjen e pagave mesatare dhe rrjedhimisht të hendekut gjinator të pagave është databaza e listepagesave nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Në këtë databazë gjenden të gjitha të dhënat e nevojshme për llogaritjen e hendekut gjinator të pagave. Megjithatë duhet theks se këto të dhëna prekin vetëm sektorin formal të punësimit, pra nuk përfshijnë të ashtu-quajturit punonjës në të zezë, për pasojë diferencimet gjinore në këtë pjesë të sektorit të punësimit nuk mund të analizohen. Për më tepër, një pjesë e pagave të deklaruar mund të jenë më të larta në realitet, pra një pjesë e pagës të disa prej të punësuarve mund të paguhet në të zezë. Këto mangësi të të dhënave mund të shmangen me implementimin e Anketës së Strukturës të të Ardhurave nga Puna. Paga mesatare e burrave dhe grave e përdorur për të llogaritur hendekun gjinator të pagave mund të jetë pagë orare, javore, mujore apo edhe vjetore.

Eurostat calculates the gender pay gap based on the Earning Structure Survey. This survey has not been conducted in Albania yet. The best source that INSTAT currently has, in order to calculate this indicator, is the data from the General Directorate of Taxation. In this database there are all the necessary data in order to calculate the gender pay gap. On the other hand it should be stated that the data include only the formal sector, and not the workers that work in the black market. As a result the gender differences in this market cannot be measured. Furthermore, there are cases that the declared wages can be higher compared to what is declared. These are some drawbacks of this database that should be taken into account and that will be eliminated when implementing the Earning Structure Survey in Albania. The mean wage of men and women used to calculate gender pay gap can be hourly, weekly, monthly or even annual wage.

Për shembull, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës përdoren më shpesh paga javore dhe vjetore (AAUW, 2016), ndërsa Eurostat përdor në përgjithësi pagën orare (Eurostat, Gender Pay Gap Statistics).

Gjithashtu Eurostat përfshin në llogaritje edhe të punësuarit me kohë të pjesëshme. Nga ana tjetër në ShBA për llogaritjen e hendekut gjinor të pagave në përgjithësi merren parasysh vetëm të punësuarit me kohë të plotë (AAUW, 2016).

Për llogaritjen e hendekut gjinor të pagave në Shqipëri është përdorur paga mesatare mujore e të punësuarve me kohë të plotë për vitin 2016, sipas bazës së të dhënave të listpagesave nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Përzgjedhja e pagës mesatare mujore të punonjësve me kohë të plotë për llogaritjen e këtij indikatori është bërë për arsye sepse në Shqipëri deklarimi i pagave si nga punonjësit ashtu edhe të punësuarit bëhet përgjithësisht mbi bazë mujore dhe rrjedhimisht janë të dhëna më të besueshme. Nga ana tjetër, në qoftë se në llogaritje do të përfshihejshin punonjësit me kohë të pjesëshme, do të duhej që indikatori të llogaritej mbi pagën orare, por në bazën e të dhënave të përdorur variabli më i vogël kohor mbi të cilin mund të llogaritet paga është ditor. Me gjithë këto mangësi të të dhënave, llogaritja e këtij indikatori është në përputhje të plotë me praktikën e përgjithshme.

$$HGJP = \frac{[47,162 - 44,221]}{47,162} = 6,3\%$$

Mbas analizimit të kësaj baze të dhënash, rezultoi se paga mesatare e burrave ishte 47.192 Lekë, ndërsa paga mesatare e grave 44.221 Lekë. Rrjedhimisht hendeku gjinor i pagave për vitin 2016 rezultoi:

For example in the US the weekly wage or annual wage is used (AAUW, 2016), meanwhile Eurostat in general uses hourly wages (Eurostat, Gender Pay Gap Statistics). Eurostat includes the part time workers as well. On the other, generally in the US, only the full time workers are taken into account (AAUW, 2016).

For the calculation of the gender pay gap in Albania, the mean monthly wage of full-time employees for 2016 was used, according to the database from the General Directorate of Taxation. The selection of the mean monthly salary of full-time employees for the calculation of this indicator is made for reasons because in Albania the declaration of salaries by both employers and employees is generally made on a monthly basis and this makes these data more reliable. On the other hand, if part-time employees were included in the calculation, the indicator should be calculated on the hourly wage basis, but in the database the smallest time variable on which the wage can be calculated is daily. Despite these data shortages, the calculation of this indicator is in full compliance with general practice.

$$GPG = \frac{[47.162 - 44.221]}{47.162} = 6.3\%$$

After the elaboration of the database of the Directorate of Taxation it resulted that the mean wage for men was 47,192 Lek, meanwhile the mean wage of women was 44,221 Lek. As a consequence the gender pay gap for 2016 resulted as follows:

## Shkaqet e ekzistencës së hendekut gjinor të pagave

Hendeku gjinor i pagave është një tregues më kompleks se një numër i vetëm, pasi ai bën shumatoren e një shumëllojshmërie rrethanash të jetëve të burrave dhe grave. Hendeku gjinor i pagave nuk ndodh vetëm si rezultat i diskriminimit gjinor, megjithëse ku është ndër faktorët kryesor. Ka edhe faktorë të tjerë që ndikojnë në ekzistencën e mënyrave të ndryshme të pjesëmarrjes në tregun e punës nga burrat dhe gratë.

### a) Zgjedhjet në tregun e punës

Në përgjithësi një pjesë e hendekut të pagave vjen si rezultat i zgjedhjeve specifike të burrave dhe grave në tregun e punës. Burrat e gratë zgjedhin fusha të ndryshme që në edukim dhe më pas edhe në profesionet ku punojnë. Këto zgjedhje luajnë rol të rëndësishëm në krijimin e hendekut të pagave.

Shpesh gratë janë disproporcionalisht të përfaqësuara në disa profesione specifike. Veçimi sipas profesioneve është një faktor që ndikon shumë në hendekun gjinor të pagave. Përveç se në shumicën e profesioneve ekziston një hendek pagash në disfavor të grave, edhe profesionet tradicionalisht të lidhur me burrat kanë tendencën të gjenerojnë paga më të larta se ata të lidhur me gratë, pavarësisht nëse këto profesione mund të kërkojnë nivele të njëjta arsimimi. (Hegewisch & Hartman, 2014)

Një zgjidhje për këtë problem do të ishte nxitja e punësimit të grave në profesionet e dominuara nga burrat, por duhet patur parasysh që këto politika duhen të fillojnë që në arsimin e grave të reja ose me trajnimin e atyre që e kanë mbyllur ciklin e arsimit zyrtar.

Në këtë publikim do të shikojmë hendekun e pagave sipas grup – profesioneve dhe aktiviteteve kryesore ekonomike ku do të shfaqet më në hollësi ky indikator.

### b) Koha larg punës si rezultat i detyrave prindërore

Të paturit fëmijë është një zgjedhje personale e cila ndikon në karrierën dhe në pagën e prindërve. Megjithatë ky ndikim është i ndryshëm për burrat dhe gratë. Leja e lindjes në Shqipëri ndikon direkt në rënien e të ardhurave neto të mamave të reja.

## The reason for the existence of gender pay gap

The gender pay gap is more complex than a single number, since it summarizes a variety of circumstances of men's and women's lives. This does not happen only because of gender discrimination, even if this is one of the most important factors. There are also other factors that influence the existence of different participation in the labor market for women and men.

### a) Choices made in labor market

In general, part of the wage gap is the result of specific men and women choices made in the labor market. Men and women choose different fields in education and then in the professions where they work. These choices play an important role in creating a wage gap.

Women are often disproportionately represented in some specific professions. Occupational segregation is a factor that greatly affects the gender pay gap. Not only there is a wage gap disadvantage for women in most professions, but also the professions traditionally associated with men tend to generate higher wages than those associated with women, regardless of whether these professions may require the same levels of education. (Hegewisch & Hartman, 2014)

One solution to this problem would be to promote women's employment in men-dominated occupations, but it should be noted that these policies should begin with the education of young women or by training those who have finished the formal education.

In this section we will analyze the gender pay gap by group-occupation and by main economic activities, where this indicator will be analyzed in more detail.

### b) Time off work as a result of parental duties

Having children is a personal choice that affects parent's career and pay. However, this impact is different for men and women. The maternity leave in Albania directly affects the decline of the net income of new mothers. Also taking into account the traditional division of duties into the family, there

Gjithashtu duke patur parasysh edhe ndarjen tradicionale të detyrave në familje, ka shumë më tepër mundësi që të jenë gratë ato që kërkojnë leje ose orare të reduktuara në punën e tyre për tu kujdesur për fëmijët apo të moshuarit në familje. Këto leje ose orare të reduktuara ndikojnë në rënien e të ardhurave aktuale të grave dhe gjithashtu ndikojnë negativisht gjatë negocijimit të pagës për gratë që kërkojnë punë të reja.

Shumë punëdhënës dhe industri, vazhdojnë të preferojnë orët sa më të gjata dhe të vazhdueshme të punës në vend të orarit fleksibël. Këto preferenca i vendosin gratë me fëmijë në disavantazh në tregun e punës. (Goldin, 2014). Shpesh këto disavantazhe mund të përkthehen në paga më të ulta për gratë, ose në braktisje të tregut të punës prej tyre.

### c) Diskriminimi gjinor

Diskriminimi gjinor është një fenomen i cili nuk kufizohet tek pagat. Ai fillon shumë heret në jetën e grave, nga aborti selektiv para se të lindin, më pas me caktim e një barre më të rëndë të detyrave shtëpiake për vajzat, vazhdon me pengesat familjare dhe shoqërore në arsimimin e tyre, me pengesat që gratë kanë për të hyrë në forcat e punës, paraqitet me anë të hendekut gjinor të pagave kur ato janë pjesë e forcave të punës dhe vazhdon deri në pleqëri.

Hendeku gjinor i pagave është një tregues i mirë për të vlerësuar diskriminimin gjinor në forcat e punës, pasi zgjedhjet e ndryshme të burrave dhe grave dhe koha larg punës apo detyrat prindërore nuk arrijnë ta shpjegojnë plotësisht madhësinë e këtij treguesi. Duke ju referuar studimeve të ndryshme vihet re se një pjesë e hendekut të pagave ngelet e pashpjeguar edhe pasi bëhen rregullimet përkatëse me anë të variablave që kuantifikojnë faktorët e përmendur më lart. Ekziston një konsensus i përgjithshëm ndërmjet studimeve të ndryshme në këtë fushë, që të paktën një pjesë e konsiderueshme e këtij hendeuku të pashpjegueshëm të pagave mund t'i atribuohet diskriminimit gjinor.

Në Shqipëri, në vitin 2016, vetëm 26,8 % e ndërmarrjeve aktive drejtohen nga gratë (INSTAT).

is a higher probability that women are those who seek leaves from work or reduced hours in order to take care for children or elderly people in the family. These leaves or reduced hours influence in the decline in current women's income and also affect negatively the wage negotiation for women seeking new jobs.

Many employers and industry continue to prefer longer and continuous hours of work instead of flexible schedules. These preferences place women in a disadvantaged position in the labor market. (Goldin, 2014).

Often these disadvantages can be translated into lower wages for women or in the abandoning of the labor market.

### c) Gender discrimination

Gender discrimination is a phenomenon which is not limited to wages. It starts very early in women's lives, from selective abortion before they are born, then imposing a heavier burden on housework for girls, continues with family and social barriers in their education, with the barriers women have to face entering the labor force, through the gender pay gap when they are part of the labor force, and continues until the old age.

The gender pay gap is a good indicator for assessing gender discrimination in the labor force, as different men and women choices and time off work or parental duties fail to fully explain the magnitude of this indicator. Referring to the various studies it is noticed that part of the wage gap remains unexplained even after adjustments are made by quantifying the factors mentioned above. There is a general consensus among various studies in this area that at least a significant part of this inexplicable wage gap can be attributed to gender discrimination.

In Albania, in 2016, only 26.8% of active enterprises are run by women (INSTAT).

Kjo tregon se gratë kanë një rrugë më të vështirë se burrat për të arritur pozicionet e larta drejtuese në ndërmarrjet e biznesit. Kjo rrugë bëhet akoma edhe më e vështirë për shkak të diskriminimit gjinor. Në një studim mbi të dhënat për forcat e punës të ShBA-ve, për një periudhë 50 vjeçare, u arrit në përfundimin që, kur gratë fillojnë të marrin pjesë në profesione që më parë kishin qënë të dominuara nga burrat, pagat mesatare të këtyre profesioneve ulen (Levanon et al., 2009).

This shows that women have a more difficult path than men to achieve senior management positions in business ventures. This road becomes even more difficult because of gender discrimination.

In a study on US labor force data for a 50-year period, it was concluded that when women start participating in occupations previously dominated by men, the average salaries of these occupations decrease (Levanon et al., 2009).

## Përbërja gjinore e focave të punës dhe hendeku gjinor i pagave sipas aktivitetit ekonomik të ndërmarrjeve.

Participation by sex and gender pay gap by economic activity of enterprises

| Aktiviteti ekonomik                                                               | Burra<br>Male | Gra<br>Women | HGjP<br>GPG | Economic activity                                                               |
|-----------------------------------------------------------------------------------|---------------|--------------|-------------|---------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Gjithsej</b>                                                                   | <b>56%</b>    | <b>44%</b>   | <b>6,3%</b> | <b>Total</b>                                                                    |
| Bujqësi                                                                           | 51%           | 49%          | 2,7%        | Agriculture                                                                     |
| Prodhim                                                                           | 43%           | 57%          | 23,3%       | Production                                                                      |
| Ndërtim                                                                           | 96%           | 4%           | -1,3%       | Construction                                                                    |
| Industri nxjerrëse,<br>Energji, gaz dhe<br>furnizimi me ujë                       | 83%           | 17%          | 2,5%        | Mining and<br>quarrying, electricity,<br>gas and water supply                   |
| Tregti, Transport,<br>Hoteleri, Shërbime<br>të biznesit dhe<br>administrative     | 64%           | 36%          | -1,3%       | Trade, Transportation,<br>Accommodation,<br>business administrative<br>services |
| Administrim publik,<br>Shërbimet Sociale dhe<br>aktivitete e shërbime<br>të tjera | 46%           | 54%          | 6,3%        | Public administration,<br>Social and other services<br>and activities           |

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe INSTAT

Source: General Directorate of Taxation and INSTAT

Gjithashtu në një studim të kohëve të fundit, u arrit në përfundimin se në forcat e punës të ShBA hendeku i pashpjeguar i pagave arrinte në 8% (Blau & Kahn, 2016).

Në çdo shoqëri pavarësisht aspekteve dhe traditave të ndryshme, në qoftë se synohet zvogëlimi i hendekut të pagave, fillimisht duhet luftuar diskriminimi gjinor në forcat e punës. Arsyeja e parë është ajo ligjore dhe morale, pasi edhe kur ligjet kundër diskriminimit të grave ekzistojnë ato shpesh nuk zbatohen nga punëdhënësit. Arsyeja e dytë është se zgjedhjet në tregun e punës dhe sjelljet prindërore janë më të vështira për tu ndryshuar.

Është një fakt i pranuar botërisht që diskriminimi gjinor ndikon negativisht si në zhvillimin ekonomik ashtu edhe në atë human të shoqërive në përgjithësi. Prandaj shumica e shoqërive përpiqen në luftimin dhe eliminimin e këtij fenomeni, pavarësisht sa të zhvilluara janë ato.

Also in a recent study, it was concluded that in the US labor force the unexplained wage gap reached 8% (Blau & Kahn, 2016).

In every society, regardless of different aspects and traditions, if the wage gap is to be reduced, gender discrimination in the labor force must first be tackled. The first reason is legal and moral, as even when anti-discrimination laws exist, they are often not applied by the employers. The second reason is that labor market choices and parental behavior are more difficult to change.

It is a widely recognized fact that gender discrimination negatively affects both economic and human development of societies in general. Therefore, most societies strive to combat and eliminate this phenomenon, no matter how developed they are.

### Hendeku gjinator i pagave në Shqipëri

Siç është thënë edhe më sipër hendeku gjinator i pagave në Shqipëri është 6,3 %. Pra paga mesatare grave është sa 93,7 % e asaj të burrave. Ky tregues mund të duket i ulët po të krahasohet me atë të vendeve të tjera. Megjithatë krahasimet e drejtëpërdrejta ndërmjet vendeve për këtë tregues nuk janë të mundura pa marrë parasysh më parë disa faktorë të tillë si, niveli i përgjithshëm i pagave apo shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës. Në përgjithësi sa më e lartë shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës aq më i lartë është edhe hendeku gjinator i pagave. Gjithashtu sa më i ulët niveli i pagave aq më i ulët do të jetë edhe hendeku gjinator i tyre, kjo vjen për shkak të attributeve matematikore të formulës së përdorur për llogaritjen e këtij treguesi. Më poshtë do të shohim hendekun gjinator të pagave dhe shkallën e pjesëmarrjes sipas aktivitetit ekonomik dhe grup – profesioneve kryesore.

### Gender pay gap in Albania

As mentioned above, the gender pay gap in Albania is 6.3%. So the mean woman wage is as much as 93.7% of that of men. This indicator may seem low compared to that of other countries. However, direct comparisons between countries for this indicator are not possible without taking into account a number of factors such as the overall level of salaries or the rate of participation in the labor force. Overall, the higher the participation rate in the labor force, the higher the gender pay gap. Also, the lower the wage level, the lower the gender gap, this is due to the mathematical attributes of the formula used to calculate this indicator.

Below we will see the gender pay gap and the participation by economic activity and main occupational groups.

### Përbërja gjinore e focave të punës dhe hendeku gjinator i pagave sipas grup - profesioneve.

Participation in labor force and gender pay gap by group-occupation

| Grup Profesionet Isco-08                                  | Burra      | Gra Women  | HGjP GPG    | Economic activity                           |
|-----------------------------------------------------------|------------|------------|-------------|---------------------------------------------|
| <b>Gjithsej</b>                                           | <b>56%</b> | <b>44%</b> | <b>6,3%</b> | <b>Total</b>                                |
| Drejtues, profesionistë dhe teknikë                       | 49%        | 51%        | 12,7%       | Managers, professionals and technicians     |
| Nëpunës, Punonjës të shitjeve dhe shërbimeve              | 60%        | 40%        | 10,5%       | Clerks, service and sales workers           |
| Punonjës të bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit               | 57%        | 43%        | 3,6%        | Skilled agriculture and trades workers      |
| Zejtare, Punonjës të montimit të pajisjeve dhe makinerive | 62%        | 38%        | 24,9%       | Plants and machine operators and assemblers |
| Profesione elementare                                     | 49%        | 51%        | 7,2%        | Elementary occupations                      |
| Forcat e armatosura                                       | 88%        | 12%        | -0,6%       | Armed force                                 |

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe INSTAT  
Source: General Directorate of Taxation and INSTAT

Tabela e mësipërme paraqet përbërjen gjinore të forcave të punës dhe hendekun gjinor të pagave sipas aktivitetit ekonomik. Në pamje të parë kjo tabelë na tregon se në sektorin e aktiviteteve ekonomike të ndërtimit dhe atë të tregtisë, transportit, hotelerisë etj, paga mesatare është më e lartë për gratë se sa për burrat. Ky fakt nuk do të thotë se në ndërmarrjet e këtyre sektorëve nuk ka diskriminim gjinor në paga, por ai është i lidhur me pjesëmarrjen e ulët të grave në forcat e tyre të punës. Një pjesëmarrje e tillë e ulët shpesh do të thotë që në këta lloj sektorësh arrijnë të punësohen vetëm ato gra që kanë arritur nivele të larta arsimi dhe kualifikimi dhe rrjedhimisht punësohen pothuajse ekskluzivisht në poste të larta pune. Në sektorin e industrisë nxjerrëse, energjisë, gazit dhe furnizimit me ujë paraqitet pothuajse e njëjta gjëndje. Për shkak të pjesëmarrjes së ulët të grave hendeku gjinor i pagave është ndjeshëm më i ulët se mesatarja kombëtare (2,5 %), por duke qenë se ky është sektori me nivelin e pagave më të lartë (paga mesatare 53.311 Lekë, INSTAT) bën që të ketë më tepër vend për diskriminim.

Për këtë arsye HGjP në këtë sektor nuk është në nivelet e sektorit të ndërtimit. Në sektorin e bujqësisë ku punojnë një numër pothuajse i barabartë grashë dhe burrash HGjP është gjithashtu më i ulët se mesatarja e vendit (2,7 %), por kjo lidhet me nivelin e ulët të pagave për këtë sektor. Në sektorin e administrimit publik, shërbimeve sociale dhe aktiviteteve të tjera hendeku gjinor i pagave paraqitet në nivele të barabarta me mesataren e vendit, edhe pse në këtë sektor është e pritshme që zbatueshmëria e ligjeve dhe rregullave kundër diskriminimit të grave të jetë më e lartë. Sektori i prodhimit është edhe sektori me hendekun më të lartë gjinor në paga (23,3 %).

Ky është sektori me përqindjen më të lartë të grave punonjëse, çka është një faktor që kontribuon në rritjen e HGjP-së. Edhe pse niveli i pagave mesatare në këtë sektor është i ulët (31.407 Lekë, INSTAT), vlera e lartë e HGjP mund të vijë si rezultat i punësimit të grave përgjithësisht në profesione me nivel të ulët page brenda këtij sektori, të cilat kërkojnë pak ose aspak kualifikim.

The table above presents the composition of the labor force by sex and the gender pay gap by economic activity. At first glance, this chart shows that in the sector of trade, transportation, accommodation etc., the mean wage is higher for women than for men. This fact does not mean that there is no gender-based pay discrimination in the enterprises of these sectors, but it is linked to the low participation of women in their labor force. Such low participation often means that only those women who have achieved high levels of education and qualification are employed in these sectors and hence are almost exclusively employed in senior positions. In the mining and quarrying, electricity, gas and water supply, there is almost the same situation. Due to low women participation, the gender pay gap is significantly lower than the national average (2.5%), but as this is the sector with the highest wage level (the average salary of 53,311 ALL, INSTAT) there is more room for discrimination.

For this reason the GPG in this sector is not at the same level as the construction sector. In agriculture, where the number of women and men is almost equal, the GPG is lower than the national average (2.7%), but this is linked with low wages in this sector. In the sector of public administration, social services and other activities the pay gap is as the national average, even if we could expect that the application of laws and rules against women discrimination to be high. The sector of production has the highest level of pay gap (23.3%).

This is the sector with the highest percentage of employed women, which is a factor that contributes to the increase of GPG. Even if the mean wage in this sector is low (31,047 Lek, INSTAT), the high level of GPG can be a result of the employment of women in profession with low wages within this sector, which may require few or no qualifications.

Rritja e pjesëmarrjes së grave në arsimin profesional do të rriste mundësitë e tyre të karrierës në këtë sektor dhe gjithashtu pagën e tyre mesatare brenda sektorit.

Një pamje më e qartë mbi hendekun gjinor të pagave mund të paraqitet duke e parë atë sipas grup – profesioneve në të njëjtën kohë me përbërjen gjinore të forcave të tyre të punës. Shikohet qartë se hendeku gjinor i pagave është më i lartë se mesatarja e vendit në të gjitha grup – profesionet përveçse për forcat e armatosura dhe për punonjësit e bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit. HGJP negative për forcat e armatosura justifikohet me faktin e pjesëmarrjes së ulët të grave në krahasim burrat. Kjo do të thotë se në këtë grup – profesion marrin pjesë përgjithësisht gra me nivele të larta arsimit dhe kualifikimi.

Grup – profesioni i punonjësve të bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit ka HGJP më të ulët se mesatarja kombëtare për shkak se ka nivelin më të ulët të pagave mesatare (27.132 Lekë, INSTAT). Kjo nuk lë vend për nivele të larta të hendekut gjinor të pagave. Gjithashtu duhet thënë se rreth 45 % e gjithë grave të punësuar punojnë në këtë sektor me nivel të ulët page. Zhvillimet teknologjike në këtë sektor si dhe arsimimi i grave do të çlirojnë një pjesë të madhe të kësaj force punëtore dhe do i orientonte ato drejt sektorëve të tjerë me nivele më të larta page. Profesionet me nivelet më të larta të hendekut gjinor të pagave janë ato të drejtuesve, profesionistëve dhe teknikëve si dhe zejtarët dhe punonjësit e montimit.

Në vlerën e lartë të HGJP në grup – profesionin e drejtuesve, profesionistëve dhe teknikëve ndikojnë si pjesëmarrja e lartë e grave ashtu edhe niveli i lartë i pagës mesatare (63.552 Lekë, INSTAT).

Grup – profesioni i zejtarëve dhe punonjësve të montimit megjithëse ka përqindje të ulët punonjësesh gra dhe nivel të ulët të pagave mesatare, paraqet hendekun më të lartë të pagave, rreth 24,9 %. Arsyeja për këtë mund të jetë se gratë që punësohen në këto profesione nuk kanë nivelet e duhura të arsimit dhe kualifikimit dhe si pasojë punësohen përgjithësisht në pozicione me nivel të ulët page. Situata është e ngjashme me atë të aktivitetit ekonomik të prodhimit dhe përmirësimit i saj mund të vijë në të njëjtën mënyrë, duke nxitur arsimin dhe kualifikimin profesional të grave.

The increase of participation of women in vocational education would increase their chances for a career in this sector and their mean wage within the sector.

A clearer picture of the gender pay gap can be seen by looking at it by group of occupation at the same time as the gender composition of their labor force. It is clearly seen that the gender pay gap is higher than the country's average in all the group - occupations except for armed forces and for skilled agriculture and trades workers. Negative GPG for the armed forces is justified by the fact of low female participation compared to males. This means that women in this group - occupation generally have high levels of education and qualification.

The group - occupation of skilled agriculture and trades workers has a lower GPG than the national average because of the lowest average wage level (27,132 Lek, INSTAT). This leaves no room for high levels of gender pay gap. It should also be said that around 45% of all women employed work in this low-wage sector. Technological developments in this sector as well as women's education would liberate a large part of this workforce and direct them to other sectors with higher wage levels. The professions with the highest levels of the gender pay gap are those of managers, professionals and technicians as well as plant and machine operator and assembler workers.

The high GPG value in the group - occupation of managers, professionals and technicians is influenced by high female participation and high level of average salary (63,552 Lek, INSTAT).

The group of plant and machine operator and assembler work profession, although it has a low percentage of female employees and a low average salary level, represents the highest wage gap, around 24.9%. The reason for this may be that women employed in these professions do not have the appropriate levels of education and qualification and are consequently generally employed in low-wage positions. The situation is similar to that of the economic activity of production and its improvement can come in the same way, promoting the education and professional qualification of women.

Kemi thënë që hendeku gjinor i pagave në Shqipëri është 6,3 %. Kjo vlerë është më e vogël se për disa vende të zhvilluara Europiane, por nuk do të thotë se në Shqipëri ka me pak diskriminim ndaj grave. Për shembull, në vitin 2015, hendeku gjinor i pagave në Gjermani ishte rreth 20 %, në Francë ishte 15,8 % dhe në Danimarkë ishte 15,1 % (Eurostat).

Megjithatë, pjesëmarrja e grave në forcat e punës dhe niveli i pagave në këto vende është shumë më i lartë se në Shqipëri. Siç e kemi përmendur edhe më lart, të dy këto faktorë ndikojnë në rritjen e hendekut gjinor të pagave. Prandaj duhet thënë që në Shqipëri duhet të fillohet me luftimin e diskriminimit gjinor që shkurajon gratë për të marrë pjesë në tregun e punës dhe gjithashtu me marrjen e masave për ndalimin e diskriminimit gjinor në tregun e punës me anë të pagës.

We have stated that gender pay gap in Albania is 6.3%. This figure is lower compared to some other developed countries in Europe, but this does not mean that Albania has lower discrimination for women. For example, in 2015, GPG in Germany was 20%, in France was 15.8% and in Denmark was 15.1% (Eurostat).

But the level of women participation in the labor force and the level of wages for these countries are much more higher than in Albania. As we have stated before this two factors influence the increase of the pay gap. We recommend that Albania must first fight the gender discrimination that discourages women to participate in labor market and in taking measure in order to stop gender discrimination in the labor market through the wage.

## Referenca - Reference

### **AAUW, 2016**

"The simple truth about the gender pay gap"

### **Eurostat 2017**

[http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Gender\\_pay\\_gap\\_statistics](http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Gender_pay_gap_statistics)

### **A. Hegewisch dhe H. Hartman, 2014**

"Occupational segregation and the Gender Wage Gap: A job half done"

### **C. Goldin, 2014**

"A grand gender convergence: Its last chapter"

### **A. Levanon, P. England dhe P.Allison, 2009**

"Occupational feminization and pay: Assessing casual dynamics using 1950 – 200 U.S. Census data"

### **D. Blau dhe M. Kahn, 2016**

"The gender wage gap: Extents, trends and explanations"

**CIP Katalogimi në botim BK Tiranë**

**Instituti i Statistikave**

Burrat dhe gratë në Shqipëri 2017 = Women  
and men in Albania 2017 / Instituti i Statistikave


Tiranë: INSTAT, 2017

... f. ; ... cm.

ISBN 978-9928-188-53-3

1. Gra 2. Burra 3. Përkatësia gjinore 4. Statistika

311.312(496.5) "2017"



## BURRAT DHE GRATË NË SHQIPËRI WOMEN AND MEN IN ALBANIA

2017

Publikimi "Burrat dhe Gratë në Shqipëri" ka si qëllim të paraqesë të dhëna dhe fakte në fusha të ndryshme sociale dhe ekonomike në vend sipas gjinisë. Këto statistika mund të përdoren për analiza gjinore më të thelluara që do të nevojiten për të integruar aspektin gjinor në të gjitha aktivitetet.

Publikimi i parë "Burrat dhe Gratë në Shqipëri" është botuar në vitin 1998. Tashmë ai është pjesë përbërëse e botimeve vjetore të INSTAT, i cili përditësohet çdo vit, me qëllimin që të përfshijë një gamë akoma më të gjerë treguesish, duke përdorur burime administrative dhe të dhëna nga anketa të ndryshme.

*The Publication "Women and Men in Albania" has the overall goal to help giving facts and data by sex in different social and economic fields in the country. These statistics can be used for deeper gender analyses that are needed to integrate a gender perspective in all activities.*

*The first publication of "Women and Men in Albania" is published in 1998. Now it is part of INSTAT publications which will be updated every year, with the aim to include a wider range of indicators from different administrative and survey sources.*

© Copyright INSTAT, 2017

